Programi: Komunikim masiv dhe gazetari

Studimet Master

Punim masteri

# GJUHA E URREJTJES NË FUSHATAT ELEKTORALE NË SHQIPËRI. RAST STUDIMOR - FUSHATA E ZGJEDHJEVE LOKALE 14 PRILL – 14 MAJ 2023

Kandidatja

Silvana Hastopalli

Mentori

Prof. Ass. Dr. Hasan Saliu

Prishtinë, 2023

## ABSTRACT

The language of public communication of politicians in Albania for a long time has become a disturbing phenomenon. This is due to the fact that the Albanian politics comes and takes a very large weight in the public opinion, which reflects in the behavior of the society. The fact that the campaigns in Albania are increasingly "violent" in the political discourse remains worrying. Opinion, viewers or even regular followers of politics who in most cases are regular voters seem to embrace this kind of violent and political behavior. This is reflected in what is called online communication due to the rapid spread of information through the online pages of professional news editors, without ignoring information channels whose source is not known, or in other words, fake news or promoting unethical communication. Media researchers have put a special emphasis on the issue of "hate speech", a term which has started to be widely used. As a result, this study will analyze the language used between the candidates in the local elections of May 14, 2023 in Albania, a race which highlighted that politicians in Albania did not choose to face each other by offering the public their governing alternative and without involving them in public debates.



**Keywords:** Language, hate, public, politics, communication, elections



## ABSTRAKT

Gjuha e komunikimit publik të politikanëve në Shqipëri prej një kohe të gjatë është kthyer në fenomen shqetësues. Kjo për faktin se politika shqiptare sa vjen dhe merr një peshë shumë të madhe në opinionin publik, gjë e cila reflekton në sjelljen e shoqërisë. Shqetësues mbetet fakti se fushatat në Shqipëri janë gjithnjë e më të “dhunshme” në diskursin politik. Opinioni, shikuesit apo edhe ndjekësit e rregullt të politikës të cilët në të shumtën e rasteve janë votues të rregullt duket se e përqafojnë këtë lloj sjellje të dhunshm e politike. Kjo reflektohet në atë që quhet komunikim online për shkak të përhapjes së shpejtë të informacionit nëpërmjet faqeve online të redaksive ta lajmeve profesionale, pa anashkaluar kanalet infomative burimi i të cilave nuk është e njohur, apo thënë ndryshe, lajme të rreme apo nxitëse të komunikimit joetik. Studiuesit e medias i kanë vënë një theks të veçantë çështjes së “gjuhës së urrejtjes”, term i cili ka nisur të përdoret gjerësisht. Si rrjedhojë në këtë studim do të analizohet gjuha e përdorur mes kandidatëve në zgjedhjet lokale të 14 majit 2023 në Shqipëri, garë e cila nxori në pah se politikanët në Shqipëri nuk zgjodhën të ballafaqohen me njëri-tjetrin duke i ofruar publikut alternativën e tyre qeverisëse dhe pa i përfshirë ata në debate publike.



**Fjalë kyçe:** Gjuhë, urrejtje, publik, politikë, komunikim, zgjedhje

**Falenderime**

Shpreh falenderim dhe mirënjohje të thellë për frymën mikëpritëse të stafit të Kolegjit dhe veçanërisht profesor Hasan Saliun për mbështetjen e fortë në përmbylljen e punimit.

Një falenderim të veçantë për prindërit dhe djemtë e mi, të cilët janë gjithmonë burim frymëzimi dhe inkurajimi për të ecur përpara. Falenderim dhe mirënjohje për mikeshën dhe kolegen time Silvja Gjepali e cila me pozitivitetin dhe kreativitetin e saj më inkurajoi edhe në oraret e tejzgjatura të punës të përmbyll me sukses tezën time. Dua të veçoj rolin e pazëvendësueshëm të mikeshës sime, pedagoges së komunikimit, Suela Musta e cila më ndihmoi me kritikat dhe sugjerimet e saj gjatë punimit shkencor.

**Deklarata e origjinalitetit / Autorësisë**

Ky Punim Diplome i nivelit Master është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi informacioni, duke iu përmbajtur rregullave për një punim të mirëfilltë shkencor.

Bazuar në njohuritë e mia, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendësi të tekstit.

Gjithashtu, deklaroj se në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të Kolegjit Universitar "AAB".

**Treguesi i lëndës**

Abstrakt.........................................................................................................................................1

Falenderime....................................................................................................................................2

Deklarata e origjinalitetit / Autorësisë............................................................................................3

Hyrje...............................................................................................................................................7

Qëllimi dhe objekti i studimit.........................................................................................................10

Objektivat.......................................................................................................................................10

Hipoteza..........................................................................................................................................11

Pyetjet që shtrohen për të vërtetuar hipotezat.................................................................................11

Metodologjia...................................................................................................................................11

Rëndësia dhe risitë e temës.............................................................................................................12

**KAPITULLI I**

1.1 Konteksti i perdorimit të gjuhës së urrejtjes...............................................................................13

1.2 Gjuha e urrejtjes në fushatat elektorale dhe koncepte dhe të së drejtës ndërkombëtare.................................................................................................................................14

1.3 Modelet teorike për gjuhën e urrejtjes në ligjërimin politik.......................................................17

**KAPITULLI II -** Gjuha e urrejtjes, historiku në politikën shqiptare, referime ligjore dhe modele teorike

teorike............................................................................................................................................20

2.1 Konteksti institucional dhe politik i gjuhës së urrejtjes në Shqipëri..........................................20

2.2 Mediat dhe pasqyrimi i gjuhës së urrejtjes në politikë...............................................................21

2.3 Ligjërimi i përdorur në fushatë nga dy liderët e politikës, Edi Rama dhe Sali Berisha.............24

3.2 Terminologjia e gjuhës së urrejtjes që mbizotëroi gjatë fushatës nga të dy liderët në rrjetet sociale. ....................................................................................................................................................25

2.4 Kandidati i PS Erion veliaj dhe përmbajtja e mesazheve në fushatë...........................................31

2.5 Kandidati Veliaj dhe terminologjia e gjuhës fyese ndaj kundërshtarit......................................32

2.6 Kandidati i koalicionit të opozitës Belind Këlliçi dhe përmbajtja e mesazheve në fushatë........33

2.7 Qasja e kandidatit Këlliçi ndaj kundërshtarit dhe terminologjia e gjuhës së përdorur...............34

2.8 Gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale dhe reagimet e audiencës online...........................................35

2.9Ligjërimi i dy kandidatëve në fokusin e ekspertëve të komunikimit..........................................38
2.10 Gjuha e urrejtjes si element marketingu online të kandidatëve për zgjedhjet...........................43

**KAPITULLI III**.........................................................................................................................48
3.1 Përfundimet.............................................................................................................................48
3.2 Sugjerime.................................................................................................................................50
3.3 Bibliografi................................................................................................................................51
3.4 Lista e Intervistave..................................................................................................................59
Merita Haklaj, gazetare – Producente ekzekutive në A2CNN........................................................59
Lutfi Dervishi – Gazetar.................................................................................................................62
Afrim Krasniqi – Drejtor ekzekutiv i Institutit shqiptar për Studime Politike.................................65
Silvja Gjepali – Eksperte e Marketingut dhe Komunikimit Digjital................................................71

**Lista e figurave**

Figura 1 - Indeksi i nivelit të medias Media Ownership Monitor 2023.............................................9
Figura 3 - Poster i fushatës zgjedhore, në një rrugë të Tiranës.......................................................25
Figura 4 - Rama në një aktivitet të fushatës në Tiranë....................................................................26
Figura 5 - Hapja e fushatës në Tiranë të Koalicionit "Bashkë Fitojmë"..........................................27
Figura 6 - Një prej fotove të fushatës së Belind Këlliçit e cila nxiti debat në publik.......................34
Figura 7 - Screenshot i faqes se Instagramit të Erion Veliaj............................................................36
Figura 8 - Screenshot i faqes se Instagramit të Belind Këlliçit.........................................................36
Figura 9 - Screenshot i marrë në internet i aplikacionit të PS, Akt1visti..........................................43
Figura 10 – Screenshot i portalit "Dosja.al".....................................................................................45
Figura 11 - Foto e posterit të Belind Këlliçit....................................................................................46
Figura 12 – Foto (screenshot ) i shpërndarjes së reagimit nga një faqe "fake" në fushatë.................................................................................................................................47
Figura 13 - Foto (screenshot ) i mbylljes së llogarisë së faqes në FaceBook "Xhamitë e Tiranës"..............................................................................................................................47
Figura 14 – Foto (screenshot ) i përgënjeshtrimit të Kmunitetit Musliman në Shqipëri botuar në media.................................................................................................................................47

## Hyrje

Historia e zhvillimeve politike në Shqipëri njeh një nivel  komunikimi me ulje dhe ngritje shumë dinamike, ku spikat gjuha me terma agresive dhe dhune verbale. Në mungesë të argumentave, shpeshherë politikanët dhe kandidatët në fushata zgjedhore zgjedhin të godasin kundërshtarin duke lënë krejt në perfieri debate për programet dhe idetë politike. Ekspertët e komunikimit e shohin përdorimin e gjuhës së dhunës si strategji të marketingut politik, me qëllim tërheqjen e vëmendjes së publikut dhe posacërisht elektoratit. Kjo gjuhë përplasjesh mbështetet dhe nga mediat, të cilat i publikojnë dhe i theksojnë në tituj termat e dhunës verbale. Nga ana tjetër veçanërisht në rrjetet sociale, publiku bëhet edhe pjesëmarrës me komente dhe transmetues i gjuhës së urrejtes së politikanëve, veçanërisht në fushata zgjedhore. Publiku, duke qenë një grup shumë i gjerë lexuesish apo shikuesish të televizioneve dhe portaleve, po këtë mesazh politik e përcjell në kohë shumë të shpejt në rrjetet personale të publikut. Ky zinxhir i pandarë, falë teknologjisë, është në veprim të vazhdueshëm duke ushqyer çdo ditë e më shumë shpërndarjen e gjuhës jo etike e cila shfokuson në mënyrën më "të shkëlqyer" vëmendjen ndaj problemeve reale me të cilat përballet shoqëria. I gjithë ky cikël komunikimi përdoret si një taktikë PR-i dhe diversioni mes politikanëve, të cilët për të mbuluar mosmbajtjen e premtimeve të tyre gjatë dekadave, vëmendjen e publikut e zhvendosin tek dhuna verbale. Në këtë kontekst media luan rol të rëndësishëm në zbërthimin e situatave ku politika kërkon të manipulojë opinionin publik. Por në Shqipëri ende mbetet shqetësues fakti se media është e orientuar politikisht dhe e kontrolluar prej saj. Për këtë fakt organizata ndërkombëtare "Reporterët pa Kufij", nënvizojnë se gazetarët në Shqipëri janë nën presion politik. "Politikanët kufizojnë pavarësinë editoriale me anë të rregullatorëve shumë të politizuar të medias dhe duke emëruar drejtues të orientuar qartësisht politikisht në median publike. Gazetarët kritikë ndaj qeverisë shpesh u nënshtrohen sulmeve politike të krijuara për t'i diskredituar ata dhe ata kanë vështirësi në aksesin e informacionit të mbajtur nga shteti. Një centralizim i kohëve të fundit i komunikimit të qeverisë mund të rezultojë në kufizime të mëtejshme për aksesin në informacionin e mbajtur nga shteti."[1] Në indeksin për vitin 2023 ndikimi politik në media ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2022 ( tabela më poshtë).

**Figura Nr. 1** Indeksi i nivelit të medias Media Ownership Monitor 2023

[1] https://rsf.org/en/country/albania, parë për herë të fundit më 12 tetor 2023



| INDEX 2023 | | INDEX 2022 | |
|---|---|---|---|
| 96 / 180 | | 103 / 180 | |
| Score : 57.86 | | Score : 56.41 | |
| POLITICAL INDICATOR | 124<br>47.76 | POLITICAL INDICATOR | 113<br>50.55 |
| ECONOMIC INDICATOR | 148<br>35.13 | ECONOMIC INDICATOR | 154<br>29.39 |
| LEGISLATIVE INDICATOR | 68<br>67.61 | LEGISLATIVE INDICATOR | 75<br>68.77 |
| SOCIAL INDICATOR | 77<br>68.37 | SOCIAL INDICATOR | 98<br>66.60 |
| SECURITY INDICATOR | 93<br>70.45 | SECURITY INDICATOR | 90<br>66.75 |

Prekja e audiencës nga media, pronarë të të cilave kanë lidhje politike, varion mes 65.18% deri në 75.86%, respektivisht sipas Abacus dhe Telemetrix data (Media Ownership Monitor, 2021).[2]

Qasja negative në mesazhet dhe qëndrimet konfliktuale të politikanëve reflektohen edhe në diskutimet mediatike. Ajo që vihet re nga ekspertët është se në vend që fushata elektorale t'i përkasë votuesit dhe programeve të zhvillimit social, ajo kontrollohet nga axhenda politike dhe mediatike. Politikanët në fushatat zgjedhore për të shpangur kontaktin e drejpërdrejt me votuesit në lidhje me platformën e tyre elektorale dhe dhënien e llogarisë nëse premtimet janë realizuar ose jo, kanë gjetur një strategji mënjanimi të përgjegjësisë si kandidat. Në lidhje me këtë Drejtuesja e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, Gerta Meta, argumenton se përse fushata zgjedhore duhet të mbizotërojë larg gjuhës së urrejtjes[3]. "Ka një gjuhë të tensionuar, ka një gjuhën inatçore. Nëse ti do të tregosh që ti po

[2] https://www.eurospeak.al/news/dritare-per-te-rinjte/1507analize-e-mediave-ne-fushate-dhe-zgjedhjet-elektorale/, parë për herë të fundit më 12 Shtator 2023

[3] https://euronews.al/fushata-elektorale-gerta-meta-rendit-dobesite-e-partive-politike/, parë për herë të fundit më 10 Gusht 2023

punon për komunitetin, duhet patjetër që të jesh konkret dhe duhet të flasësh dhe të punosh me komunitetin. ". Meta e cilëson të pakuptueshme, se si një kandidat nuk pranon dhe denjon që të ulet përballë me kundërshtarin. "Kjo është një mungesë respekti, që kandidatët nuk po rriten ideologjikisht në mënyrë të menjëhershme për të kapur atë trendin se ti je në garë, por në të njëjtën kohë duhet të mendosh se për kë garon"[4], thotë ajo. Qëndrimet e grupimeve të shoqërisë civile kanë gjithnjë e më shumë në fokus ligjërimin fyes dhe kërcënues të politikanëve sa herë që afrohen fushatat zgjedhore. Kështu gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e 14 Majit, Aleanca kundër urrejtjes e përbërë nga Avokati i Popullit, Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Shoqatës "Këshilli Shqiptar i Medias" e cilëson kërcënuese diskurisin elektoral të kandidatëve pasi vlerëson se "Gjuha e urrejtjes krijon një mjedis ku mund të ndodhë dhuna e vërtetë"[5]. Shqetësues mbetet fakti i ndërlidhjes së terminologjive joetike me transmetimin në media, si reflektues kryesor i sjelljes së shoqërisë në Shqipëri. Ligji zgjedhor nuk parashikon ende një rregullues. Këtë shqetësim ka ngritur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Ilirian Clibashi. "Mediat online dhe rrjetet sociale, të cilat janë një risi, nuk e kanë rregulloren që duhet të kenë, kjo nuk i pengon partitë politike dhe Kuvendin e Shqipërisë të trajtojnë marrëdhëniet ndërmjet partive politike, fushatave zgjedhore dhe mediave sociale"[6]. Në konferencën e organizuar nga Këshilli i Europës pak javë para mbajtjes së zgjedhjeve lokale, përgjegjësi në detyrë i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë Olsi Dekovi nënvizoi se "gjuha e urrejtjes gjatë fushatave zgjedhore ndikon dhe dekurajon qytetarët për të votuar, margjinalizon dhe nxit urrejtje mes grupeve të ndryshme të qytetarëve. Ndaj shoqëria civile dhe media kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e respektit, ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit dhe dekurajimin e partive politike dhe kandidatëve në përdorimin e gjuhës së urrejtjes"[7].

[4] https://euronews.al/fushata-elektorale-gerta-meta-rendit-dobesite-e-partive-politike/, parë për herë të fundit më 13 tetor 2023
[5] https://www.kmd.al/deklarate-e-aleances-kunder-urrejtjes/
[6] https://www.coe.int/sq/web/tirana/-/p%C3%ABrmir%C3%ABsimi-i-standardeve-etike-gjat%C3%AB-fushat%C3%ABs-elektorale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-dhe-p%C3%ABrgjegj%C3%ABsia-e-medias-p%C3%ABr-t%C3%AB-luftuar-p%C3%ABrdorimin-e-gjuh%C3%ABs-s%C3%AB-urrejtjes, parë për herë të fundit më 14 tetor 2023
[7] https://www.coe.int/sq/web/tirana/-/p%C3%ABrmir%C3%ABsimi-i-standardeve-etike-gjat%C3%AB-fushat%C3%ABs-elektorale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-dhe-p%C3%ABrgjegj%C3%ABsia-e-medias-p%C3%ABr-t%C3%AB-luftuar-p%C3%ABrdorimin-e-gjuh%C3%ABs-s%C3%AB-urrejtjes, parë për herë të fundit më 14 tetor 2023

**Qëllimi dhe objekti i studimit**

Qëllimi i këtij punimi është analiza e përmbajtjes së ligjërimit nga politikanët kryesorë shqiptarë, trajtuar dhe nga pikëpamja e marketingut politik, gjatë fushatës zgjedhore lokale në periudhën 14 Prill – 14 Maj 2023. Gjuha e komunikimit politik veçanërisht në fushata pasqyrohet masivisht nga mediat online dhe ato elektronike, duke bërë që impaktet tek audienca të jenë të shumta dhe komplekse.

**Objektivat**

- Ky punim studimor ka disa objektiva, të cilët synojnë të nxjerrin në pah natyrën e ligjërimit tipik në fushatat zgjedhore, bazuar tek gjuha e urrejtjes;

- Të analizohet përmbajtja e komunikimit politik të kryetarëve të partive dhe kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale 2023, duke u përqëndruar tek gjuha e urrejtjes.

- Të trajtohet strategjia e PR-it të kandidatëve në optikën e ligjërimit politik dhe termave të gjuhës së përdorur, si në takimet dhe aktivitetet publike ashtu edhe të komunikimit online me audiencat e rrjeteve gjatë fushatës zgjedhore.

- Pasqyrimi i gjuhës së urrejtjes dhe përplasjeve verbale mes kandidatëve nga mediat kombëtare, televizionet dhe portale më të ndjekura.

- Analiza e reagimeve të audiencave në rrjetet sociale .

**Hipoteza**

Ky studim ngrihet mbi hipotezën e formuluar, si vijon: Gjuha e urrejtjes në fushatë elektorale përdoret si instrument i ligjërimit politik dhe pjesë e një strategjie PR për të tërhequr vëmendjen e publikut.

**Pyetjet që shtrohen për të vërtetuar hipotezat:**

- Si përdoret gjuha e urrejtjes nga stafet e PR-it të partive për marketing të fushatës së kandidatëve?
- Cilët nga kandidatët dhe liderët përdorin më së shumti gjuhën e urrejtjes dhe cilat ishin shprehjet më të përdorshme?
- Cili është ndikimi që ka në publik, ligjërimi me gjuhë urrejtjeje të politikanëve?

**Metodologjia**

Për këtë punim përdoret metoda e hulumtimit që përfshin tregues cilësorë dhe sasiorë. Është kryer një monitorim i komunikimit mes palëve gjatë fushatës zgjedhore të 14 majit 2023, rrjetet sociale, portalet e lajmeve si dhe web-et e kanaleve televizive, kronikave televizive gjatë një muaj fushate.

- Në punim analizohet përmbajtja e diskursit publik dhe gjuha e kandidatëve kryesorë të fushatës së kryeqytetit, Belind Këlliçi nga demokratët dhe Erion Veliaj nga socialistët.

- Monitorohen përmbajtja e qëndrimeve në statuset e rrjeteves sociale të kandidatëve dhe edhe mbulimi i këtyre ngjarjeve në portale online.

Në punim përcillen gjetjet nga monitorimi i portaleve kryesore, mes të cilëve janë dhe platformat në Internet të televizioneve informative BalkanËeb, Klan TV, Euronews.al, Lapsi.al, Shqiptarja.com, ku është pasqyruar në mënyrë të plotë fushata zgjedhore në Tiranë 14 prill – 14 maj. Janë përzgjedhur këto media për shkak të paanshmërisë, proporcionalitetit të kohës të pasqyrimit, audiencës së lartë, nivelit profesional të gazetarëve, numrit të klikimeve, komenteve dhe interaktivitetit në komunikim me ndjekësit.
Janë kryer intervista me drejtues te televizioneve dhe portaleve dhe me gazetarë të mediave kombëtare, të cilët ndjekin rregullisht politikën
Pjesë e rëndësishme e punimit është aspekti teorik mbi komunikimin politik, duke përfshirë një analizë krahasimore me gjuhën e kandidatëve në fushatë, mes politikanëve të Shqipërisë dhe

Kosovës, artikuj të analistëve mbi “hate speech” e përdorur në fushatë nga liderët politikë, intervista me gazetarët të cilët kanë ndjekur disa fushata në Shqipëri.

Në punim përfshihen modelet teorike të shkollave amerikane dhe të disa vendeve europiane të komunikimit mbi gjuhën e urrejtjes në fushatat elektorale. Njëherësh është përfshirë baza ligjore përkatëse[8], si dhe vendimet e Komisionit Qëndror Zgjedhor për thyerjet e parimeve të etikës në ligjërimet publike.

**Rëndësia dhe risitë e temës**

Çështjet e cënimit të parimeve të etikës dhe gjuhës së urrejtjes tek politikanët në fushata zgjedhore janë trajtuar deri diku nga ekspertë të medias dhe shkencave politike në Shqipëri por, studime të mirëfillta shkencore janë ende të pakëta. Kjo tezë studimore sjell përqasje dhe qëndrime të patrajtuara më parë, në hulumtimin e ligjërimeve elektorale midis kandidatëve zgjedhorë të mazhorancës dhe të opozitës. Të dhënat statistikore për termat e diskriminimit fyerjes dhe bullizmit të përdorura nga kandidatët, analiza krahasimore dhe gjetjet e studiuesve të komunikimit mbi gjuhën e urrejtjes në fushata zgjedhore, janë ndër risitë kyce të studimit. Ky punim do të jetë një kontribut i shtuar, jo vetëm për studentët e shkencave të komunikimit dhe medias, por edhe për ata që studiojnë në degët e shkencave politike dhe sociale.

[8] Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë , ligj nr. 10 019, datë 29.12.2008, (i përditësuar)

## Bibliografi


"Article 20", United Nations, Human Rights, International Covenant on Civil and Political Rights url: https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights#:~:text=Article%2020,-1.&text=prohibited%20by%20Laë.-,2.,shall%20be%20prohibited%20by%20law . (Parë për herë të fundit 6 qershor 2023).

"Deklaratë e "Aleancës kundër urrejtjes", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, maj, 25, 2023, url: https://www.kmd.al/deklarate-e-aleances-kunder-urrejtjes/, (Parë për herë të fundit më 16 tetor 2023.)

"Fushata elektorale, Gerta Meta rendit "dobësitë" e partive politike", lajm i marrë nga intervista në EuroNews Albania, mars, 26, 2021. url: https://euronews.al/fushata-elektorale-gerta-meta-rendit-dobesite-e-partive-politike/, (Parë për herë të fundit më 13 tetor 2023).

"Përmirësimi i standardeve etike gjatë fushatës elektorale në Shqipëri dhe përgjegjësia e medias për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes", Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, mars, 20, 2023, url:https://www.coe.int/sq/web/tirana/-/p%C3%ABrmir%C3%ABsimi-i-standardeve-etike-gjat%C3%AB-fushat%C3%ABs-elektorale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-dhe-p%C3%ABrgjegj%C3%ABsia-e-medias-p%C3%ABr-t%C3%AB-luftuar-p%C3%ABrdorimin-e-gjuh%C3%ABs-s%C3%AB-urrejtjes , (Parë për herë të fundit më 14 tetor 2023).

"Political Context", Reporters Withourt Borders, 2022. url: https://rsf.org/en/country/albania, (Parë për herë të fundit më 12 tetor 2023)

"Rregullimi dhe vetërregullimi i medias online", Insituti Shqiptar i Medias, fq 56, 212, 2018, url: https://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online_1.pdf, (Parë për herë të fundit më 17 korrik 2023.)

"The First Amendment", The White House, The Constitution,https://www.whitehouse.gov/about-the-white-house/our-government/the constitution/#:~:text=The%20First%20Amendment%20provides%20that,for%20a%20redress%20of%20grievances (Parë për herë të fundit më 5 qershor 2023)

Abcnews.al, "Veliaj: Belo, sapuni i Metës. Sulmon direkt rivalin e Foltores: E rëndë, nuk ka as diplomë", Prill, 26, 2023, url: https://abcnews.al/veliaj-te-mos-kesh-diplomen-e-gjimnazit-eshte-e-rende-por-me-e-rende-eshte-te-behesh-sapun-per-fytyrat-e-berishes-dhe-metes/, (Parë për herë të fundit 10 Korrik 2023).

Abrashi, Gazmend & Reçi, Ardita. (2023). Motivation of Employees in the Public Sector through Organizational Communication Case Study: Vala Mobile Company, Kosovo. *Journal Human Research in Rehabilitation. 13*(2), 313-320. https://doi.org/10.21554/hrr.092314

Abrashi, Gazmend, & Sallauka, Urim. (2022). Use of Information Technology in Academic Library Practice. *The International Information & Library Review*, *54*(4), 380–386. https://doi.org/10.1080/10572317.2022.2124834

Ackerman, B., & Fishkin, J. (2004). Deliberation day. New Haven: Yale University Press. Blumenthal, S. (1980). The permanent campaign: Inside the world of elite political operatives. Boston: Beacon Press.

AMA. "Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes: Gjestet fyese në posterat e fushatës, të papranueshme dhe të dënueshme me ligj!", 25 prill 2023. url: http://ama.gov.al/aleanca-kunder-gjuhes-se-urrejtjes-gjestet-fyese-ne-posterat-e-fushates-te-papranueshme-dhe-te-denueshme-me-ligj/, (Parë për herë të fundit 15 Korrik 2023).

Avokati i Popullit, Aleanca Kundër Gjuhës Së Urrejtjes, https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/Memorandume-

marreveshje/aleanca-kundr-gjuhs-s-urrejtjes-517/, (2020), (Parë për herë të fundit më 15 maj 2023)

Axhami, Loreta, "Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive", AMA, fq8/56, 2018, url: http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/HATE-SPEECH-1.pdf. (Parë për herë të fundit më 18 korrik 2023.)

Baker, Edwin."Hate Speech". In The Content and Context of Hate Speech: Rethinking Regulation and Responses, edituar nga Michael Herz, and Peter Molnar, 57/80. Neë York: Cambridge University Press. 2012. url: https://www.thereporterethiopia.com/article/hate-speech-and-social-media-hoë-govern-it. (Parë për herë të fundit më 20 tetor 2023).

Balkanweb.com, "Premtoi garë pa zhurmë e postera, pse ndryshoi strategji Rama? Nga fyerjet te nervozizmi në fushatë", Maj, 12, 2023. url: https://www.youtube.com/ëatch?v=nBk3J1EZTu4, (Parë për herë të fundit 15 Korrik 2023).

Blumler, Jay G. "The Fourth Age of Political Communication." Politiques de Communication, 2016

Calvert, Clay. "Hate Speech and Its Harms: A Communication Theory Perspective." Journal of Communication. 1997.

Drożdż, Michał. T. 35 (2016) nr 5. «Hate Speech in Media Discourse.» Acta Universitatis Lodziensis. Folia Litteraria Polonica. F.20. url: https://rm.coe.int/16800c170e, (Parë për herë të fundit më 7 qershor 2023.)

Dworkin R. Freedom's Laë: The Moral Reading of the American Constitution. Oxford, UK: Oxford Univ. Press. 1996.

EuroNews "Këlliçi sapun për Berishën e Metën", Veliaj: Nuk e lan dot fytyrën e tyre", Prill, 26, 2023. url: https://euronews.al/kellici-sapun-per-berishen-e-meten-veliaj-nuk-e-lan-dot-fytyren-e-tyre/, (Parë për herë të fundit 7 Korrik 2023).

Faxweb.al, "Veliaj sulmon Këlliçin, e quan 'dhëndri ynë': Falas thoshte edhe Sudja, por njerëzit nuk gënjehen më, e kanë kuptuar që qyl nuk ka!", Prill, 19, 2023, url: https://www.faxweb.al/veliaj-sulmon-kellicin-e-quan-dhendri-yne-falas-thoshte-edhe-sudja-por-njerezit-nuk-genjehen-me-e-kane-kuptuar-qe-qyl-nuk-ka/. (Parë për herë të fundit 10 Korrik 2023).

Feinberg J. The Moral Limits of the Criminal Laë, Volume 1: Harm to Others. Oxford, UK: Oxford Univ. Press. 1984.

Fjala.al, "Këlliçi sapun për Berishën e Metën", Veliaj: Nuk e lan dot fytyrën e tyre". Prill 26 2023 url:https://fjala.al/2022/12/20/veliaj-sulmon-kellicin-kandidati-i-opozites-eshte-kukull-qe-drejtohet-nga-saliu/, (Parë për herë të fundit 7 Korrik 2023).

Fortuna, Paula, and Sérgio Nunes. "A Survey on Automatic Detection of Hate Speech in Text." ACM Computing Surveys, Vol. 51, No. 4. 2018.

Fortuna, Paula, dhe Sérgio Nunes. 2018. "A Survey on Automatic Detection of Hate Speech in Text." ACM Computing Surveys. doi:https://doi.org/10.1145/3232676. F.5

Françoise, Tulkens. "The hate factor in political speech ëhere do responsibilities lie? Report." url: https://rm.coe.int/16800c170e , (Parë për herë të fundit më 7 qershor 2023. 2013)

Gjergji, Bashkim. "Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive", AMA, Nëntor, 14, 2018 fq 9/ 56,

Gjergji, Bashkim. "Realiteti i mediave audiovizuale dhe gjuha e urrejtjes", AMA, Nëntor, 14, 2018 fq 10/56, url: http://ama.gov.al/ëp-content/uploads/2019/09/HATE-SPEECH-1.pdf, (Parë për herë të fundit më 15 korrik 2023.)

Ingrida Unikaitė-Jakuntavičienė, Journal of Political Marketing, ''Political Campaign Professionalization in Lithuanian Elections'', 2023

Izmaku, Xh. & Gashi, Rr. (2023). The Impact of Social Media on the Development of Women Especially in Transition States. *HighTech and Innovation Journal 4*(3), 560-574. http://dx.doi.org/10.28991/HIJ-2023-04-03-07

Izmaku, Xhevahire & Gashi, Rrezarta. (2023). The Impact of Social Media on the Development of Women  Especially in Transition States. *HighTech and Innovation Journal 4*(3), 560-574. http://dx.doi.org/10.28991/HIJ-2023-04-03-07

Kadiu, Klisman. "Analizë e mediave në fushatë dhe zgjedhjet elektorale." EuroSpeak, korrik 2015. url: https://www.eurospeak.al/news/dritare-per-te-rinjte/1507analize-e-mediave-ne-fushate-dhe-zgjedhjet-elektorale/, (Parë për herë të fundit më 12 tetor 2023).

Kelly D. Patterson Brigham Young University Daniel M. Shea Allegheny College - Local Political Context and Negative Campaigns: A Test of Negative Effects Across State Party Systems, fq 2

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve (Ndryshuar me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 41) url: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf, fq 82, 1995. (Parë për herë të fundit më 18 maj 2023). 2013

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligj nr. 10 019, dhjetor, 29 2008. url: https://www.pp.gov.al/rc/doc/kodi_zgjedhor_24.pdf , (parë për herë të fundit më 16 tetor 2023.)

KQZ, "KQZ organizoi konsultimin "Fushata Zgjedhore – Financimi, roli dhe përgjegjësia e medias, si dhe gjuha e urrejtjes dhe standardet etike gjatë fushatës zgjedhore", mars 20, 2023, https://kqz.gov.al/2023/03/20/kqz-organizoi-konsultimin-fushata-zgjedhore-financimi-roli-dhe-pergjegjesia-e-medias-si-dhe-gjuha-e-urrejtjes-dhe-standardet-etike-gjate-fushates-zgjedhore/ (Parë për herë të fundit më 15 maj 2023)

Lees-Marshment, Jennifer, and Darren G. LillekerPolitical Marketing: A Comparative Perspective. Manchester: Manchester Press, 2005.

Lilleker, Darren G., Jens Tenscher, and Václav Štětka. "Toëards Hypermedia Campaigning? Perceptions of Neë Media's Importance for Campaigning by Party Strategists in Comparative Perspective." Information, Communication & Society, 2015.

Londo, Ilda, "Gjuha e urrejtjes, propaganda, dhe dezinformimi në median shqiptare", Shtator 2020, url:https://seenpm.org/wp-content/uploads/2020/10/Resilience-publication-1-ALB-national-language.pdf, (Parë për herë të fundit më 17 korrik 2023.)

Magin, Melanie, Nicole Podschuëeit, Jörg Haßler, and Uta Russmann. "Campaigning in the Fourth Age of Political Communication: A Multi-Method Study on the Use of Facebook by German and Austrian Parties in the 2013 National Election Campaigns." Information, Communication & Society, 2017.

News Bomb, "Doni gamor të fortë apo veshgjatë?", Rama batuta në Kamëz: Po çudisni Shqipërinë, kalamajtë tuaj po rrafin Tironën mendjemodhe të Lalit, prill, 22, 2023, gjetur në NewsBomb.net, url: https://newsbomb.al/doni-gamor-te-forte-apo-veshgjate-rama-batuta-ne-kamez-po-cudisni-shqiperine-kalamajte-tuaj-po-rrafin-tironen-mendjemodhe-te-lalit/, (Parë për herë të fundit 27 Qershor 2023).

Partia Demokratike e Shqipërisë, "Berisha thirrje nënave dhe vajzave: Shpalleni fushatën, fushatë tuajën dhe ju do ta shpëtoni Shqipërinë, me dashurinë tuaj dhe përkushtimin tuaj". Prill, 17, 2023. url: https://pdsh.al/berisha-thirrje-nenave-dhe-vajzave-shpalleni-fushaten-fushate-tuajen-dhe-ju-do-ta-shpetoni-shqiperine-me-dashurine-tuaj-dhe-perkushtimin-tuaj/, (Parë për herë të fundit 3 Korrik 2023).

Partia Demokratike e Shqipërisë, "Berisha: "Ne nuk jemi njëlloj. Ne kishim gabime, por ishim në ngritje. Me këta, njerëzit dhe shoqëria bien poshtë e më poshtë", Prill, 15, 2023

Partia Demokratike e Shqipërisë, "Berisha: I bëj thirrje çdo kandidati, apo kandidateje që gabimisht është regjistruar për Bravën-Alibashën, të japë dorëheqjen!", Prill, 18, 2023
Partia Demokratike e Shqipërisë, "Berisha: Kandidatët tanë, kandidatët e lirisë. Me guxim dalin para jush dhe kërkojnë votëbesim, vendimmarrës jeni ju, jo kryesia e PD!" Prill, 23, 2023. url: https://pdsh.al/berisha-kandidatet-tane-kandidatet-e-lirise-me-guxim-dalin-para-jush-dhe-kerkojne-votebesim-vendimmarres-jeni-ju-jo-kryesia-e-pd/, (Parë për herë të fundit 3 Korrik 2023).
Partia Demokratike e Shqipërisë, "Berisha: Më 14 maj, duke votuar opozitën, votohet shpresa, rivendosja e pluralizmit, rikthimi i Shqipërisë në rrugën e demokracisë!" Maj, 11, 2023 url: https://pdsh.al/berisha-me-14-maj-duke-votuar-opoziten-votohet-shpresa-rivendosja-e-pluralizmit-rikthimi-i-shqiperise-ne-rrugen-e-demokracise/, (Parë për herë të fundit 30 Qershor 2023).
Partia Demokratike e Shqipërisë, "Berisha: Nuk ka më amnisti për qeveritarët hajdutë. Pas datës 14 maj, Edi Rama do ti ketë muajt të numëruar!" Prill, 24, 2023 url: https://pdsh.al/berisha-nuk-ka-me-amnisti-per-qeveritaret-hajdute-pas-dates-14-maj-edi-rama-do-ti-kete-muajt-te-numeruar/, (Parë për herë të fundit 1 Korrik 2023).
Partia Socialiste, "Berat, me premtimin se transformimi i qytetit do të jetë më mbresëlënës në 4 vitet e ardhshme, le t'u japim votëbesimin më të mirëve". Maj, 5, 2023 https://ps.al/newsroom/berat-me-premtimin-se-transformimi-i-qytetit-do-te-jete-me-mbreselenes-ne-4-vitet-e-ardhshme-le-tu-japim-votebesimin-me-te-mireve/. (Parë për herë të fundit 23 Qershor 2023).
Post R. dhe Weinstein & Hare, "Hate speech". faqe 123/38, 2009.
Rama, Edi. Takim me vajza e gra në Durrës, RTV Klan, gjetur në Youtube: url: https://www.youtube.com/ëatch?v=whc4aol1Z6g. (Parë për herë të fundit 20 Qershor 2023).
Rama, Edi. Takim me vajza e gra në Himarë, RTV Klan, gjetur në Youtube: url: https://www.youtube.com/watch?v=uXc_Qa3_ëf0, (Parë për herë të fundit 29 Qershor 2023).
Rama, Edi. Takim me vajza e gra në Vlorë, RTV Klan, gjetur në Youtube: url: https://www.youtube.com/watch?v=H7L5l5qJbRQ, (Parë për herë të fundit 29 Qershor 2023).
Saliu H. & Llunji V. (2022). Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence. *Information & Media*, 93, 62-76. https://Doi.org/10.15388/Im.2022.93.61
Saliu, Hasan & Abrashi, H. (2023). The Return of Media Diplomacy: Examples from Kosovo. *Jurnal Ilmu Sosial dan Ilmu Politik 27*(1), (74-89). https://doi.org/10.22146/jsp.73710
Saliu, Hasan (2015). *Komunikimi në diplomacinë publike: Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës.* Prishtinë: Kolegji AAB.
Saliu, Hasan (2018). Multiple Target Audiences, Critical Analysis of Pristina-Belgrade Dialogue. *On-line Journal Modelling the New Europe,* 26, 108-123. Doi:10.24193/OJMNE.2018.26.08
Saliu, Hasan (2020). Public Diplomacy and Related Concepts from the Perspective of Lasswell's Communication Formula. *Jahr – European Journal of Bioethics, 11*(2), 357-376. https://Doi.org/10.21860/j.11.2.2
Saliu, Hasan (2020). The Evolution of the Concept of Public Diplomacy from the Perspective of Communication Stakeholders. *Medijska istraživanja, 26* (1), 69-86. https://Doi.org/10.22572/mi.26.1.4
Saliu, Hasan (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave, XXXVII*(96–97), 189–207. https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf

Saliu, Hasan (2022). Public Diplomacy or Public Glocalization? Rethinking Public Diplomacy in the post-Truth Era. *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 157-175. DOI: 10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175
Saliu, Hasan (2022). Rethinking Media Diplomacy and Public Diplomacy Towards a New Concept: Digital Media Diplomacy. *Online Journal Modelling the New Europe, 39*, 1-24. DOI: 10.24193/OJMNE.2022.39.01
Saliu, Hasan (2023). Narratives of Public Diplomacy in the post-Truth Era: The decline of Soft Power. *Communication & Society, 36*(2), 209-224. https://doi.org/10.15581/003.36.2.209-224
Saliu, Hasan, Bicaj, A. (2022). The Digital Competence of Future Teachers in Kosovo. In L. Tomczyk & L. Fedeli, (eds), *Digital Literacy for Teachers. Lecture Notes in Educational Technology*. Springer, Singapore. (275-290). https://Doi.org/10.1007/978-981-19-1738-7_15
Saliu, Hasan, Reçi, A. & Abrashi, Gazmend (2023). Revisiting Hallin and Mancini's media model: Albania and Kosovo. *Balkan Social Science Review*, 21. 235-255. https://doi.org/10.46763/BSSR2321235s
Saliu, Hasan, Rexhepi, Z., Shatri, S. & Kamberi, M. (2022). Experiences with and risks of internet use among children in Kosovo. *Journal of Elementary Education*, *15*(2), 145–164. https://Doi.org/10.18690/rei.15.2.145-164.2022
Saliu, Hasan; Çipuri, Ramadan. & Izmaku, Xhevahire. (2024). Gutenberg's death in the Balkans: news values in Kosovo and Albania. *Cogent Arts & Humanities*, *11*(1), 2303197. https://doi.org/10.1080/23311983.2024.2303197
Stephan Russmohl: 'Gazetaria', Tiranë: K&B , 2010.
Strömbäck, Jesper. "Political Marketing and Professionalized Campaigning." Journal of Political Marketing 6, 2007.
Shqiptarja.com, "Rama kërcen me socialistët në Elbasan: Më 14 maj të largojmë 'zorrën qorre' dhe Xhiken, janë turpi i botës (Berisha dhe Meta)", prill, 23, 2023, url: https://shqiptarja.com/lajm/rama-takim-ne-elbasan-une-e-hoqa-appendesitin-koha-te-largojme-zorren-qorre-dhe-xhiken-nga-shqiperia-jane-turpi-i-botes, (Parë për herë të fundit 25 Qershor 2023).
Shqiptarja.com, "Rama në Pallatin e Sporteve në Durrës: Anin e keni 'shalqi me provë', pse të merrni kungullin e dalë nga zorra qorre", prill, 24, 2023 url: https://shqiptarja.com/lajm/rama-ndez-sallen-e-pallatit-te-sporteve-ne-durres-anin-e-keni-shalqi-me-prove-pre-te-merrnin-kungullin-e-dale-nga-zorra-qorre, (Parë për herë të fundit 27 Qershor 2023).
Shqiptarja.com, "Veliaj në Kombinat: Mos e ngacmoni Belindin sa të futet në listën e PD, se e kemi dhëndër në PS!". Shkurt, 9, 2021. url: https://shqiptarja.com/lajm/veliaj-ne-kombinat-mos-e-ngacmoni-belindin-sa-te-futet-ne-listen-e-pd-se-e-kemi-dhender-ne-ps. (Parë për herë të fundit 7 Korrik 2023).
Téwodros . Workneh "Hate Speech Predicament: Seeking Antidotes Beyond a Legislative Response", 2020.
Téwodros w. Workneh, "Hate Speech Predicament: Seeking Antidotes Beyond a Legislative Response". 2020.
Titley, Gavan, Ellie Keen, and László Földi. "Starting Points for Combating Hate Speech Online: Three Studies about Online Hate Speech and Ways to Address It." Council of Europe. 2014. https://rm. coe.int/1680665ba7.
Top Channel, "Si mund të pranojë një shqiptar kandidat nga zorra qorre"/ Rama në Divjakë: Puna i ka thënë të gjitha ato që duheshin", prill, 25, 2023 url: https://top-channel.tv/2023/04/25/si-mund-te-pranoje-nje-shqiptar-kandidat-nga-zorra-qorre-rama-ne-divjake-puna-i-ka-thene-te-gjitha-ato-qe-duheshin/. (Parë për herë të fundit 23 Qershor 2023).

url: http://ama.gov.al/ëp-content/uploads/2019/09/HATE-SPEECH-1.pdf, (Parë për herë të fundit më 18 korrik 2023.)
url:https://pdsh.al/berisha-i-bej-thirrje-cdo-kandidati-apo-kandidateje-qe-gabimisht-eshte-regjistruar-per-braven-alibashen-te-jape-doreheqjen/. (Parë për herë të fundit 1 Korrik 2023).
url:https://pdsh.al/berisha-ne-nuk-jemi-njelloj-ne-kishim-gabime-por-ishim-ne-ngritje-me-keta-njerezit-dhe-shoqeria-bien-poshte-e-me-poshte/, (Parë për herë të fundit 3 Korrik 2023).